



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 445/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazic dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Hashim Deshishku nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), selia në Prishtinë, paraqitur kundër Rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me date 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë :

VENDIM

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Hashim Deshishku nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), selia në Prishtinë.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimet (VV) 1503E/01R dhe 1503E/02R.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën –II- të këtij diapozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik LDK selia në Prishtinë, me të cilën pretendohet se në komunën e Obiliqit, në fshatin Breznicë, në dy vendvotime 1503E/01R ka pasur 60 vota kurse në 1503E/02R ka pasur 57 vota, të cilat nuk janë regjistruar në Formularin e Rezultatit të Kandidatit (FRK). Me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këto kuti votimi me numër 1503E/01R dhe 1503E/02R.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar Formularët e Rezultatit të Kandidatit.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Hashim Deshishku nga subjekti politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV 1503E/01R dhe 1503E/02R.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 1503E/01R për Komunën e Obiliqit ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr.122617, 0037551, 0037552 dhe 0037553 ndërsa shiriti i mesëm nr. 0037553 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr. 122620.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr 35 nga radhët e subjektit politik LDK ka poseduar 60 vota ne FRK e vjetër cila ishte plotësuar ne VV1503F/01R ndërsa pas rinumërimit ne QNR i njëjti i posedon 27 vota. Ndërsa pas rinumërimit te fletëvotimit nga ana e hetuesve te PZAP-it rezulton se i njëjti ka 30 vota prej tyre 28 te vlefshme dhe 2 fletëvotime janë te shënuara 6 kandidat dhe si te tilla konsiderohen te pavlefshme.

Këto fletëvotime janë rinumëruar në QNR dhe të njëjtat nuk janë fotokopjuar nga ana e hetuesve të PZAP-it.

Nga arsyet e cekura më lartë del se është bërë gabim i paqëllimshëm gjatë plotësimit të FRK-ve në QV 1503E/01R dhe 1503E/02R. në Komunën e Obiliqit, me ç’rast numri i votave të kandidatit Hashim Deshishishku nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1, 117.4 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 445/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha.**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*